



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



## STRATEGJIA E INFORMIMIT PUBLIK

### HYRJE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton parimet themelore për organizimin e zgjedhjeve, mbi bazën e votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, në përputhje me ligjin mbi zgjedhjet.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatitë, mbikëqyrë, drejton dhe verifikon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

Përgjegjësitë e organeve për menaxhimin dhe organizimin e zgjedhjeve në Kosovë rregullohen me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe Ligjin mbi Financimin e Subjekteve Politike.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre parimeve kushtetuese dhe ligjore, KQZ-ja, dhe Sekretariati i KQZ-së, ndërmarrin aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore.

Kjo strategji e Informimit Publik ka për qëllim që të bëjë të mundur që KQZ-ja, të perceptohet si institucion kompetent dhe transparent në respektimin e parimeve kushtetuese, ligjore dhe atyre ndërkombëtare në administrimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Strategjia ka për qëllim që të informojë qytetaret me të drejtë vote për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për votim, mënyrën, kohën dhe vendin për votim, si dhe identifikimin e grupeve të synuara, bashkëpunimin me shoqërinë civile, përcjellja e informacioneve mbështetëse tek mediat, subjektet politike dhe vëzhguesit gjatë periudhës para-zgjedhore dhe zgjedhore.

KQZ-ja do të organizoj aktivitete për informimin e votuesve dhe palëve të interesuara në të gjitha fazat e procesit zgjedhor dhe të themeloj mekanizma bashkërendimi me palët tjera të interesuara për një përcjellje të mesazheve informuese.

Kjo strategji ka për qëllim të përmbushë këtë funksion dhe këtë objektiv të përgjithshëm.

## **QËLLIMI**

Qëllimi i përgjithshëm i fushatës së informimit publik, është t'i informoj votuesit rreth procesit zgjedhor, funksionimit të procesit dhe të drejtave të tyre sipas Kushtetutës së Kosovës dhe ligjit për zgjedhjet.

Fushata, do të jetë gjithashtu e projektuar dhe do të zbatohet për të mbështetur përgjegjësitë dhe veprimtaritë specifike të KQZ-së, të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale (siç është periudha e shërbimit votues, konfirmimi dhe kundërshtimi, votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta, procedurat e votimit, votimi jashtë Kosovës).

Kjo strategji është përgatitur që KQZ-ja, ti përmbush obligimet që ka për informimin e votuesve gjatë të gjitha fazave të procesit zgjedhor.

Përveç informimit të votuesve, KQZ-ja, gjithashtu është përgjegjëse edhe për informimin e palëve tjera të interesuara për zgjedhje sikurse subjektet politike, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat lidhur me aktivitetet zgjedhore në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në kohën e duhur.

Qëllimi i këtij projekti, është informimi i votuesve për të gjitha fazat e procesit zgjedhor, motivimin për të marrë pjesë në zgjedhje, rolin, të drejtat e votuesve gjatë procesit zgjedhor.

## **OBJEKTIVAT**

Objektivat e fushatës së informimit publik për zgjedhje janë:

- Dhënia e informatave për procesin zgjedhor votuesve dhe subjekteve politike.
- Informimi i votuesve mbi të drejtat e tyre për votim.
- Informimi dhe edukimi për rëndësinë e votës së tij.
- Informimi dhe edukimi për mënyrën e votimit.
- Inkurajimi për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje.
- Zvogëlimi i numrit të fletëvotimeve të pavlefshme.
- Informimi mbi vendvotimin dhe ditën (kohën) e votimit.

## PARIMET THEMELORE TË INFORMIMIT PUBLIK

Fushata e informimit publik, është e bazuar në 5 parime themelore:

**Gjithë përfshirja** - Kërkon angazhimin jo vetëm të kanaleve tradicionale të informimit, si për shembull TV, radio dhe shtypi, por edhe portalet e lajmeve, rrejtët sociale si dhe mobilizimin e të gjitha kontakteve me publikun me të gjitha institucionet relevante (qofshin administrata lokale, OJQ-të e ndryshme apo institucione ndërkombëtare).

**Thjeshtësia e materialeve** - Të gjitha materialet, audio, vizuale, dhe ato të shtypura, do të kenë një përmbajtje të thjeshtë, që kuptohen lehtë. Dizajni i materialit do të jetë pjesë e identitetit pamor që lehtë mund të identifikohet nëpërmjet përdorimit të sloganit, logos dhe ngjyrave të njëjta.

Për të gjitha prodhimet e TV dhe radio spoteve do të jetë vetëm një tingull.

**Fleksibilitet dhe evoluimi i vazhdueshëm** - Përherë, duhet analizuar ecurinë dhe efektet e fushatës të cilat duhet t'iu përshtaten rrethanave konkrete.

Nuk duhet të ketë boshllëqe mes shpërndarjes dhe nevojës operacionale për informim.

**Paanshmëria** - Procesi i informimit publik, do të jetë i pa-anshëm dhe pa ndikime politike apo partiake. Përmbajtja e materialeve të informimit publik, synon që të informoj dhe motivoj votuesit që të marrin pjesë në zgjedhje, dhe nuk favorizon ndonjë subjekt politik që garon në zgjedhje.

**Koordinimi** - Qasja gjithëpërfshirëse kërkon një koordinim të mirë dhe bashkëveprim të SKQZ-së, ndërmjet departamenteve dhe institucioneve brenda dhe jashtë vendit.

## QASJA E INFORMIMIT PUBLIK

Fushata e Informimit Publik, do të dizajnohet dhe zbatohet për të mbështetur veprimtaritë e KQZ-së, të përcaktuara në ligj. Gjithashtu fushata do të vejë theksin mbi procesin zgjedhor, të drejtat e votuesit, rëndësinë e pjesëmarrjes, dhe rolin e KQZ-së, si institucion shtetëror me mandat kushtetues.

Të gjitha materialet, elektronike dhe ato të shtypura, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga dizajni, do të identifikohen lehtë nga të gjitha kategoritë e votuesve. Përmbajtja e sloganit dhe materialet tjera reklamuese, qoftë në media të shkruara apo elektronike, do të jenë lehtë identifikues dhe akceptuese për të gjitha grup moshat e votuesve.

## INFORMIMI PËRMES MJETEVE TË KOMUNIKIMIT

Për të arritur qëllimin e informimit publik, do të përdoren disa nga mjetet e komunikimit, si:

**Masmediat** - Mjeti kryesor i komunikimit me votuesit do të jenë mediat. Vëmendje e veçantë, do t'i kushtohet sigurimit të hapësirës në TV dhe radio, të cilat kanë ndikim të madh në opinion. Prandaj informacionet më të rëndësishme do të vendosen në programet e televizioneve dhe radiove. Po ashtu, përmes gazetave do të publikohen njoftimet më të detajuara dhe më teknike.

**Portalet e lajmeve** - Do të përdoren shtatë portale (dy të minoriteteve) me të vizituara nga qytetarët brenda dhe jashtë Kosovës, ku do të publikohen informatat e të gjitha fazave të procesit zgjedhore. Në mesin e portaleve do të jetë edhe rtklive.com. Reklamimet do të bëhen në banerat standard, VIDEO dhe për secilën fazë artikujt do të sponzorohen. Pasi që të klikohet, baneri mund të i drejtoj ata tek ueb faqja e KQZ-së.

**Ueb faqja e KQZ-së** - Informatat mbi zgjedhjet, do të vendosen në ueb faqen e KQZ-së. Materialet për informimin publik që do t'i ofrohen votuesve në tërësi, do të publikohen në ueb faqe që votuesit të kenë mundësi të shkarkojnë nga interneti të gjitha informacionet e nevojshme zgjedhore. Materialet e vendosura do të përfshijnë: materialet në forme tekstuale, vizuale dhe ato audio (radio).

**Rrjetet Sociale** - Rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube), janë një mënyrë shumë efikase me kosto të ulët për të arritur tek shumica e votuesve, e posaçërisht votuesit e rinj. Përmes profilit të saj në rrjetet sociale, KQZ-ja, do të informoj votuesit në mënyrë të rregullt dhe kohë reale për procesin zgjedhor.

KQZ-ja, do të vendos fotografi të aktiviteteve të ndryshme dhe bëj shpërndarjen e materialeve informuese, në mënyrë që të shpërndahen tek shumica e votuesve që janë aktiv në rrjete sociale.

**Vendosja e një Ekranit para Teatrit Kombëtar** - Një ekran me dimensione minimum 3 m x 2.5 dhe jo më i madh se 4m x 6m, para teatrit kombëtar (me marrëveshje në mes të KQZ-së dhe Teatrit) ku do të transmetohen vazhdimisht materialet informuese dhe njoftime të ndryshme, spotet, si dhe shpallja e rezultateve preliminare të transmetuara nga sistemi i K-vote.

Kjo ndikon në rritjen e transparencës dhe kredibilitetin e KQZ-së, mirëpo edhe të informoj qytetarët mbi proceset dhe rezultatet e zgjedhjeve.

**Personalitetet** - Kurdo që të jetë e mundur, të përdorim rekomandimet e njerëzve me autoritet për informimin e votuesve si sportistë, aktorë, këngëtar, intelektualë, profesionist të ndryshëm, duhet t'i shmangemi personaliteteve politike.

**Mesazh nga Kryetarja e KQZ** - Kryetarja e KQZ-së, jap mesazhe motivuese për të gjithë votuesit. Me theks të veçantë mesazhe motivuese për femrat që të marrin pjesë në zgjedhje, jo vetëm që ato të votojnë, mirëpo edhe të jenë pjesë e procesit, trupave menaxhues zgjedhor dhe vëzhgues. Mesazhet, përveç transmetimit në TV-të dhe radiot, duhet të distribuohen përmes

rrjeteve sociale, organizatave të Rrjetit të Grave të Kosovës, në mënyrë që të arrihen sa më shumë femra.

**Ekipet dhe tendat mobile** - Do të vendosen në të gjitha komunat. Ky aktivitet, ofron mundësinë e takimeve, bisedave dhe ndërveprimin e drejtpërdrejt me votuesit, si dhe ofrimin e informacioneve në mënyrë të drejtpërdrejt.

**Tavolina Informative** - Do të vendosen në Aeroportin e Prishtinës, përmes së cilave një numër i konsiderueshëm i qytetarëve jashtë vendit, e kanë si pikë kalimi për të ardhur në Kosovë gjatë pushimeve. Tavolinat informuese, do të informojnë këta qytetarë duke dhënë fletushka që përmbajnë detajet e aplikimit për votim jashtë Kosovës, afatet kohore për regjistrim, si dhe mënyrën e plotësimit të fletëvotimit dhe afatin e dorëzimit.

**Shpërndarja e billbordave, posterave dhe fletushkave** - Aktiviteti i shpërndarjes, do të jetë një mënyrë e rëndësishme e përhapjes së informatave dhe porosive edukuese tek grupet specifike. Për secilën fazë të procesit zgjedhor disa fletushka do të shpërndahen në zyrat e ofiqarisë, në selitë e subjekteve politike, dhe degët e tyre nga ZLKZ-të, si dhe me gazetatat ditor.



## **BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT DHE INSTITUCIONET**

### Mediat

Është me rëndësi që mediat të kuptojnë plotësisht rolin dhe përgjegjësinë e KQZ-së dhe të sistemit zgjedhor ashtu siç e përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale. Kjo strategji përfshin mbulimin e materialeve informues për media që t'i ndihmojë ato, dhe t'i raportojnë saktë ngjarjet.

### Shoqëria civile

Organizatat e shoqërisë civile, kanë një rol të rëndësishëm në nxitjen e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe për t'iu ofruar votuesve informacionet e duhura për ta ushtruar të drejtën e votimit. Inkurajohet shoqëria civile për pjesëmarrje aktive në sensibilizimin e nevojës për dalje më të madhe në zgjedhje.

KQZ, do të vendos kontakt me organizata që promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e votuesve, me theks të veçantë, votuesit e rinj, votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta si dhe komuniteteve pakicë.

### Zyra për Barazi Gjinore si dhe Rrjeti i Grave të Kosovës

Ftohen përfaqësueset e organizatave të rrjetit të grave të Kosovës, që të informojnë dhe motivojnë përfitueset e tyre që të marrin pjesë në zgjedhje. KQZ, do të ofroj materialet e nevojshme në formë elektronike në mënyrë që këto organizata, ti kenë në dispozicion, dhe të ofrojnë ndihmën e nevojshme që kërkohen nga këto organizata.

### Bashkëpunimi me Ambasadat dhe Konsullatat

Materialet e përgatitura (posterat, fletushkat) me informatat për dy fazat e procesit zgjedhor do të shpërndahen tek ambasadat dhe konsullatat e Kosovës, në mënyrë që ato të shpërndajnë informacionet tek qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë. Materialet do të kenë informata kryesore, që tregojnë për të drejtën që ata votues e kanë për të votuar, mënyrën e aplikimit, procesin e votimit, dhe informata të tjera relevante.

### Bashkëpunimi i Shoqatave dhe Klubeve të Mërgimtarëve

Përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës, do të identifikohen shoqatat dhe klubet e mërgimtarëve, me të cilët KQZ-ja, do të ndaj informata në formë

elektronike posterët, fletushkat, në mënyrë që këto shoqata dhe klube të shpërndajnë informata tek Kosovarët jashtë vendit.

#### Subjektet politike

Subjektet politike, kanë një rol të veçantë që votuesit ta kuptojnë procesin zgjedhor dhe të marrin pjesë në të. Megjithëse kjo kryhet në mënyrë të përgjithshme përmes fushatës zgjedhore, subjektet politike gjithashtu japin këshilla dhe ndihmë për votuesit individualisht. Për të ndihmuar në lidhje me këtë, strategjia përfshinë zhvillimin dhe prodhimin e materialeve informuese, që do të ndihmonin përfaqësuesit e subjekteve në dhënien e këshillave dhe ndihmës së saktë për votuesit.

Rol të veçantë në informimin e subjekteve politike për çështje me rëndësi të procesit zgjedhor, ka Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike ku për secilën fazë të procesit zgjedhor planifikohet që ti dërgoj në mënyrë elektronike materialet informuese në selitë e Subjekteve Politike.

#### Shoqata Handikos

Materialet e përgatitura do të shpërndahen tek kjo shoqatë, për të informuar votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta, mbi procesin zgjedhor në përgjithësi. KQZ-ja, gjithashtu do të i ndihmoj Handikosit që të mbledhin aplikacione për votuesit të cilët nuk kanë mundësi që të votojnë fizikisht në vendvotim. Do të mbahen takime me udhëheqësit e kësaj organizate, për tu informuar këta votues.

#### Shoqata e të Verbërve të Kosovës

Do të përgatiten fletushka të përkthyer në alfabetin e brajlit për votuesit e verbër dhe do të mbahen takime me përfaqësuesit e Shoqatës së tyre, gjithashtu këta votues do të informohen për mundësinë e votimit në vendvotim me asistencë, apo me shabllonet e brajlit.

#### Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

Gjatë përgatitjes së TV spoteve, KQZ-ja, do të ofroj gjuhën me shenja për votuesit e kësaj kategorie. KQZ-ja gjithashtu do të ofroj materiale për Shoqatën Kosovare të Shurdhërve, dhe do të mbaj takime me përfaqësuesit e tyre në mënyrë që të shpërndahen informacione për këta votues.

#### Shoqata Dawn Syndrome Kosova

Materialet e përgatitura do të shpërndahen tek kjo shoqatë, për të informuar votuesit e kësaj kategorie mbi procesin zgjedhor në përgjithësi. Takime me përfaqësuesit e kësaj shoqate do të mbahen me qëllim të informimit të këtyre votuesve.

#### Vëzhguesit Zgjedhor Ndërkombëtar

Gjatë tërë procesit zgjedhor, organizatat vendore dhe ato ndërkombëtare të akredituara për vëzhgim, do të monitorojnë proceset zgjedhore, administrimin e procesit zgjedhor dhe në veçanti, veprimtaritë e ditës së zgjedhjeve.